



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:277587

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06524813

**AC-I-24-0569**

**Në ankesën e**

**Paditësi/Ankuesi**

**M S** nga Prishtina, i përfaqësuar nga avokati J R nga Ferizaj.

**Kundër**

**E paditura/Ankuesja**

**N.SH "ABC Genci " (në likuidim)**, të cilin e përfaqëson **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses dhe të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1097 të datës 10 korrik 2024 pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 29 nëntor 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar .**
- Teksti ekzistues i pikës I të dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së -I-rë të DHPGJS, C-IV-15-1097 i datës 10 korrik 2024 ndryshohet me tekstin vijues "Aprovohet pjesërisht ankesa e paditësit si e bazuar, ndryshohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit, PRN066-0054 i datës 29 prill 2015 dhe obligohet AKP-ja që në emër të pagave të pa paguara për vitin 2013 ti paguaj**

**paditësit shumë prej 4,600.00 euro, si dhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e avokatit në shumë prej 104 euro, të cilat shuma do të paguhen në procedurën e likuidimit, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj”.**

**3. Vërtetohet pika II dhe III e dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së –I-rë të DHPGJS, C-IV-15-1097 i datës 10 korrik 2024.**

**4. Ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar.**

**5. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 18 Qershor 2015, paditësi përmes postës, në DHPGJS të Gjykatës, ka parashtruar kërkesës për ri shikimin e Vendimit kundër Vendimit, PRN066 – 0054 të datë 29 prill 2015 të Autoritetit të Likuidimit (AL) pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh) “ABC Genci” me seli në Prishtinë (në likuidim) e me të cilin i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e tij në emër të kompensimit e pagave të pa paguara në shumë prej 8.165.40 € për vitin 2009-2013, nga NSh “ABC Genci” me seli në Prishtinë (në likuidim) e me të cilën ka kërkuar që gjykata të nxjerr aktgjykim dhe të aprovohet padia dhe kërkesa e paditësit si e bazuar, dhe të vërtetojë se vendimi i AL-së është jo ligjor.

Pala paditëse, e ka titulluar parashtresën si “*Kërkesë për ri shikim të Vendimit*”, mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi, në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesë apo ankesë.

Paditësi në këtë padi/kërkesë, ka theksuar se e kundërshton vendimin e AL-së si të pabazuar për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Tutje paditësi thekson se nuk i ka realizuar të ardhurat personale në shumën e lartshënuar dhe se disa here iu është drejtuar kësaj ndërmarrje për realizimin e kësaj të drejte dhe se borxhi figuron në ndërmarrjen e lartshënuar. Paditësi i propozon gjykatës që të merr aktgjykim e me

të cilin, aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit, të detyrohet e paditura, Agjencioni Kosovar i Privatizimit, që paditësit, t'ia paguaj borxhin kryesor për pagat e mbetura të pa paguara në shumën prej 8.165.40 euro.

Kërkesës së tij për ri shikimin e Vendimit, si provë, paditësi, i ka bashkangjitur: Vendimin e AL-së, PRN066-0054 të dt.29.04.2015 dhe asnjë provë tjetër.

Me dt.22 mars 2024, e paditura, AKP-ja, ka paraqitur mbrojtjen e saj ndaj ankesës së ushtruar kundër Vendimit, PRN066 – 0054 të dt.29 prill 2015, të Autoritetit të Likuidimit (AL) përmes se cilës ka theksuar se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht, se ankesa e parashtruesit – paditësit është e pa pranueshme në përputhje me Ligjin 04/L-034, dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2 të

Ligjit, Nr.06/L-086, dhe se ankesa e parashtruesit është e pabazuar nga neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, se AL-ja, ka kryer vlerësimin e drejtë kërkesës dhe ka gjetur atë të pavlefshëm ku citin se *"Elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme"*, e me propozimin që gjykata, t'ia refuzoj ankesën e paditësit si të papranueshme dhe të pa bazuar dhe t'a vërtetoj Vendimin e Autoritetit të Likuidimit (AL) në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit, Nr.06/L-086, dhe se kësaj mbrojtje, ia ka bashkangjitur kopjen e Vendimit të AL-së, PRN066-0054 të dt.29.04.2015.

Me datë 4 prill 2024, paditësi, ka paraqitur përgjigje ndaj mbrojtjes së të paditurës, AKP-së e në të cilën, në mes tjerash ka theksuar se ai i ka ndërmarre te gjitha veprimet juridike konform dispozitave ligjore e më tutje ka theksuar se Agjencioni ka pasur për obligim t'ia paguaj të ardhurat personale dhe atë konform Ligjit për Punën e Bashkuar, te bëhet pagesa në bazë të kritereve të caktuara mbi të ardhurave personale dhe atë në bazë të nenit 127 dhe 129, të gjitha këto veprime janë bere pa fajin e punëtorit. Me tej ka theksuar se e paditura ne mbrojtjen e saj në bazë të neneve 36.1 dhe 36.2 të shtojcës së ligjit për AKP-në, në lidhje me nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, kërkesa për paga është parashkruar tri vite pas parashtrimit. Paditësi thekson se kjo periudhë duhet të përcaktohet për secilin

muaj, e jo për tere periudhën kohore të kërkuar andaj nëse periudha e parashkrimit aplikohet vetëm për atë pjese të asaj periudhe për të cilat kërkohe pagat atëherë ajo nuk ndikon në terë kërkesën. Ankuesi i propozon gjykatës që mbrojtjen e të paditurës AKP-së ta hedh si të pabazuar, ndërsa kërkesa e tij për pagat e papaguara në shumë prej 8.165.40 euro, të aprovohet, si dhe shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në mbrojtje në shumë prej 156 euro dhe e se kësaj përgjigje ankuesi i ka bashkangjitur autorizimin për përfaqësim të tij të datë 2 prill 2024.

Me datë 22 Maj 2024, gjykata me urdhër ka kërkuar nga paditësi, që në afatin prej 7 (shtate) ditëve pas ditë së pranimit të këtij urdhri, ta plotësoj padinë (kërkesën për ri shqyrtim) e saj të datë 18qershor 2014, dhe atë në përputhje me dispozitat ligjore të lartë cekura, në atë mënyrë që kësaj padie (kërkese), t'ia bashkëngjis, kopjen e listës së pagave të NSh-së, Librezën e punës lidhur me Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), ABC "Genci" me seli në Prishtinë (në likuidim), si dhe provat tjera në të cilën i ka ndërtuar thëniet në padi (kërkesë për ri shqyrtim) e nën pasojën se nëse paditësi, nuk vepron brenda afati të dhënë sipas pikës I të dispozitivit të këtij urdhri, gjykata në bazë të nenit 36 të Ligjit, Nr.06/L – 086 të dt.30 maj 2019 të Dhomës e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK), padinë/ankesën e tij, do të hedh poshtë si të papranueshme ose të njëjtën padi (kërkesë për ri shqyrtim), do t'a refuzoj si të pabazuar.

Me datë 28 maj 2024 paditësi është përgjigjur në urdhrin e gjykatës, ku ka bashkangjitur si provë: Kopjen e Vendimit të AL-së me nr.PRN066-0054, datë 29 prill 2015, kopjen e formularit për parashtrimin e kërkesës jo pronësore në likuidim me nr.38966/2015, datë 24 mars 2015, kopjen e bordit të përkohshëm menaxhues të ndërmarrjes shoqërore KDSHF "Genci", dhe atë njoftim lidhur me vendimin e bordit të drejtoreshave të Agjencionit Kosovar të Privatizimit, i dt.30.04.2014, kopjen e njoftimit për paditësin nga Agjensioni Kosovar të Privatizimit me nr.215/2015, i dare 10 shkurt2015, kopjen e njoftimit nga AKP-ja, mbi lajmërimin se likuidimi i ndërmarrjes, ka filluar me datë 02 shkurt 2015, kopjen e certifikatës e kontributit pensional dhe mbajtjes në burim të tatimit në paga, i datë 20 janar 2015, përgjigjen e marr nga Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit në lidhje me autoritetin administrativ e datës 24 shkurt 2003, njoftimin mbi pranim dorëzimit e valutës se ndërmarrjes me date 14 maj 2014, i cili është bërë në mes të drejtorit të ndërmarrjes tash zv, drejtor i ndërmarrjes M S dhe emri i pranuesit drejtoresha e ndërmarrjes shoqërore

KDSHF "Genci" M V, vërtetimin i datës 31 dhjetor 2014, ku theksohet se : KDSHF "Genci" se ndaj paditësit M S ka obligim për vitin 2009 shumen prej 3.565.40 euro, për vitin 2013 shumen prej 4.600.00 euro, e ku borxhi i tërësishëm ndaj paditësit është 8.165.40 euro, kontratën e punës për kohë të caktuar të lëshuar nga punëdhënësi i ndërmarrjes, dhe kopja e letërnjoftimit të paditësit.

Me datë 18 qershor 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së urdhër, ka kërkuar nga e paditura, që në afatin prej 3 (tre) ditëve pas ditë së pranimit të këtij urdhri, të parashtroje kopjen e Listës së pagave të NSH "ABC Genci", pastaj Librezën e punës, si dhe prova tjera për paditësin M S.

Me datë 25 qershor 2024, e paditura, AKP-ja, është përgjigjur në urdhrin e gjykatës, ku ka bashkangjitur si provë: kopjen e formularit për parashtrimin e kërkesës jo pronësore në likuidim me nr.38964/2015, datë 24 mars 2015, kopjen e formularit për parashtrimin e kërkesës jo pronësore në likuidim me nr.38965/2015, datë 24 mars 2015, kopjen e formularit për parashtrimin e kërkesës jo pronësore në likuidim me nr.38966/2015, datë .24 mars 2015, kopjen e vërtetimit i datës.31 dhjetor 2014, ku theksohet se KDSHF "Genci" se ndaj paditësit, M S ka obligim për vitin 2009 shumen prej 3.565.40 euro, për vitin 2013 shumen prej 4.600.00 euro, e ku borxhi i tërësishëm ndaj paditësit është 8.165.40 euro, kopjen e vërtetimit i dt.07 korrik 2008, kopjen e letërnjoftimit, kopjen e Vendimit të AL-së, PRN066-0051 të dt.29.04.2015 lidhur me dëmshpërblimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, dhe kopjen e Vendimit të AL-së, PRN066-0054 të dt.29.04.2015 për pagat e pa paguara.

Me datë 10 korrik 2024, shkalla e I-rë e DHPGJ-së me Aktgjykimin, C- IV-15-1097, me ankesën e paditësit vendosë si vijon:

**I.** PRANOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, M S nga Prishtina e paraqitur kundër Vendimit, PRN066-0054 të dt.29.04.2015 të të paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoritetit të Likuidimit (AL), dhe NDRYSHOHET pjesërisht, Vendimi, PRN066-0054 i dt.29.04.2015 i të paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoritetit të Likuidimit (AL), dhe OBLIGOHET, e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoriteti i Likuidimit (AL), që paditësit, M S nga Prishtina, t'ia kompensoj pagat e të pa paguara për periudhën

kohore për vitin 2012, 12 (dy mbëdhjetë) paga mujore, në shumën prej 1.780.00 €, dhe për vitin 2013, 12 (dymbëdhjetë) paga mujore, shumën prej 1.780.00 €, e në shumën e përgjithshme prej 3.560.00 € (tre mijë e pesë qind e gjashtëdhjetë) nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "ABC Genci" me seli në Prishtinë (në likuidim) dhe se shuma e pranuar, duhet të përmbushet në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit e nga shuma totale e kërkuar prej 8.165.40 € për pagat e të pa paguara për periudhën duke filluar nga viti 2009 deri në vitin 2013.

**II.** REFUZOHET pjesërisht si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, M S nga Prishtina për kompensimin e pagave të pa paguara mbi shumën e pranuar e duke filluar nga viti 2009 e deri në vitin 2011 nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "ABC Genci" me seli në Prishtinë (në likuidim) dhe Vendimi, PRN066-0054 i dt.29.04.2015 i të paditurës, Autoritetit të Likuidimit (AL) të Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), VËRTETOHET pjesërisht, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

**III.** DETYROHET, e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoriteti i Likuidimit (AL), që paditësit, M S nga Prishtina, i përfaqësuar nga av. J R nga Ferizaj, t'ia kompensoj shpenzimet procedurale dhe atë në emër të përpilimit të Përgjigjes në mbrojtje në shumën prej 104.00 € (një qind e katër).

Shkalla e I-rë e DHPGJ-së ka arsyetuar Gjykata pas shqyrtimit të të gjitha provave të cilat gjendjen në shkresat e lëndës, vlerësimit të tyre dhe konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendje faktike, ka gjetur se pjesërisht qëndron pretendimi i të paditurës, AKP-së se kërkesa e paditësit për një pjesë të kërkesëpadisë së tij, i është parashkruar në kuptim të nenit 36.2.2. të Shtojcës së Ligjit të, Nr.04/L – 034 për AKP-në si dhe nenit 608 i Ligjit mbi Punën e Bashkuar ( publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut lidhur me nenin 372 të LMD-së, Nr.29 të vitit 1978, derisa pjesërisht nuk qëndron pretendimi i të paditurës, AKP-së të se kërkesa e paditëses, i është parashkruar për pjesën tjetër të kërkesës së tij e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore sepse paditësi ka qenë punëtor i Ndërmarrjes Shoqërore (N.Sh), "ABC Genci" me seli në Prishtinë (në likuidim) e në mungesë të provave në mbështetje të pretendimit rreth çështje së pagesës së akontacionit si dhe se sa a ka pasur të drejtë paditësi, që të jetë nënshkruar i listës gjegjëse për pagat e nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se paditësi, kishte ofruar shërbime punë për Ndërmarrjen Shoqërore (N.Sh), "ABC Genci" me seli në Prishtinë (në likuidim), i kishte mbetur borxh pagat e pa paguara për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i

takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e pranuar pjesërisht derisa pjesërisht kërkesa e tij, i është parashkruar për pjesën tjetër të kërkesëpadisë. Andaj gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore, kërkesëpadia e paditësit për një pjesë të kërkesëpadisë për kompensimin e pagave të pa paguara dhe atë se sipas një përlogaritjeje, pra për vitin 2013, paditësit, i takojnë 12 paga mujore neto për vitin 2012, në shumën prej 1,780.00 €, dhe për 12 paga mujore për vitin 2013, në shumën prej 1,780.00 €, e në shumën e përgjithshme prej 3.560.00 € e nga totali i tyre i kërkuar në shumën prej 8.165.40 € për periudhën kohore per vitet 2009 - 2013, dhe se shuma prej 3.560.00 € e pagës mujore të paditësit në shumën prej 1.780.00 €, ka qenë e marr për bazë në procedurën e likudimit, dhe se këtë shumë edhe kjo gjykatë e mori si bazë për llogaritjen e tillë të pagave të pa paguara nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), "ABC Genci" me seli në Prishtinë (në likuidim). Pra gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit, është pjesërishte e bazuar dhe se Vendimi i AL-së, PRN066-0054, të dt.29.04.2015 pra, duhet të ndryshohet pjesërisht si dhe të detyrohet e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë, që paditësit, M S nga Prishtina, t'ia paguaj pagat e pa paguara në shumën dhe periudhën e lartë shënuar për pagat e të pa paguara, derisa për pjesa e kërkesëpadisë së paditësit mbi pjesën e pranuar të saj, është pjesërisht e pabazuar për shkak të parashkrimit të pjesshëm të kërkesës për kompensimin e pagave të papaguara e duke filluar nga viti 2009,2010 dhe 2011 nga Ndërmarrja Shoqërore (NSH), "ABC Genci" me seli në Prishtinë (në likuidim) dhe mbi shumën e pranuar, dhe si e tillë pjesa e kërkesëpadisë së paditësit, duhet të refuzohet pjesërisht si e pabazuar dhe Vendimi, PRN066-0054 i dt.29.04.2015 i të paditurës, Autoritetit të Likuidimit (AL) të Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), duhet të vërtetohet pjesërisht, si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike, dhe nuk e konsideron të nevojshme të japë arsyetime tjera ligjore.

Me datë 26 korrik 2024 paditësi e dorëzon në DHPGJ-së një ankesë kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJ-së, C-IV-15-1097 të datës 10 korrik 2024, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet Aktgjykimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rigjykim, ose të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet tërësisht kërkesëpadia e

paditësit si e bazuar. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se me Aktgjykimin e ankimuar është shkelur neni 182 par,2 pika n) të LPK-së, pasi që dispozitivi është kontradiktor me vet veten dhe nuk përmban arsye për faktet vendimtare dhe provat materiale. Tutje paditësi pohon se ka ndërmarrë të gjitha veprimet juridike ndërsa AKP-ja ka pasur obligim të paguaj të ardhurat personale. Tutje ai pohon se ankesën e tij e ka mbështetur me prova dhe se AKP-ja kishte obligim që për vitin 2009 të paguaj shumën prej 3,565,40 euro dhe për vitin 2013 shumën prej 4.600.00 euro ose borxhi i tërësishëm prej 8,165.40 euro. Paditësi pohon se e paditura nuk e ka kontestuar lartësinë e kërkesës por ka vërtetuar se obligimi i përgjithshëm ndaj paditësit është shuma e mbetur borxh prej 8,165.40 euro. Prandaj nga këtë arsye Shkalla e I-rë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ajo nuk është marrë me provat të cilat paditësi i ka paraqitur në Gjykatë.

Me datë 02 gusht 2024, e paditura (në tekstin e mëtejme ankuesja) në DHPGJS ka dorëzuar një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-15-1097, të datës 10 korrik 2024, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të refuzohet ankesa e paditësit e paraqitur ndaj vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë ka bërë një vlerësim të gabuar të situatës faktike dhe rrjedhimisht edhe asaj juridike. AKP pohon se kërkesa e paditësit është e parashkruar pasi që nuk ka asnjë dëshmi para AL-së që ai i ka dorëzuar këto kërkesa para ndonjë gjykate apo organi para se të përfundonte periudha e parashkrimit. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur që Gjykata i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra përkatësisht dy afate të ndryshme dhe atë afatin për parashtrimin e kërkesave që është afat procedural për të dorëzuar dëshminë e kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afatin ligjor për të kërkuar mbrojtjen e të drejtës së pretenduar- afatin e parashkrimit i cili në këtë rast është 3 vjet në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Këto dy afate janë të ndara dhe të dallueshme të cilat duhet të përmbushen nga çdo pretendues në mënyrë që të pranohet kërkesa.

Me datë 23 gusht 2024, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtesë dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtesë paditësi i kundërshton pretendimet ankimore të AKP-së duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe e mbështet Aktgjykimin e ankimuar duke e konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Tutje



paditësi pohon se AKP-ja me ankesën e saj vetëm i ka përsëritur argumentet e dhëna të cilat i ka prezantuar në procedurën në Shkallë të I-rë, dhe nuk ka paraqitur asnjë provë të re ose argument ligjor në procedurën ankimore. Tutje paditësi pohon se nuk qëndrojnë pretendimet e AKP-së lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, pasi që gjykata e ka konfirmuar se kërkesa e ankuesit nuk ishte parashkruar dhe mbi këtë bazë ia ka njohur borxhin e të paditurës për paditësin. Në këtë parashtresë paditësi ka kërkuar që të refuzohet ankesa e AKP-së si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 26 gusht 2024, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është plotësisht i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet pjesërisht të ndryshohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 24 mars 2015, e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit dhe i ka kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara për

vitin 2009 në shumë prej 3,565.40 euro, dhe për vitin 2013 në shumë prej 4,600.00 euro, e që të dy shumat për dy vitet e cekura është 8,165.40 euro.

Autoriteti i Likuidimit me vendimin e ankimuar e ka refuzuar këtë kërkesë me arsyetimin se ajo është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit verën se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin e ankimuar e aprovon pjesërisht ankesën si të bazuar dhe paditësit ia njeh të drejtën në paga të pa paguara për vitin 2012 në shumë prej 1,780.00 euro dhe për vitin 2013 në shumë prej 1,780.00 euro ose në shumën prej 3,560.00 euro duke nxjerrë konstatimin se pagat e këtyre viteve nuk janë parashkruar ndërsa pagat e periudhës paraprake konsiderohen të parashkruara.

Kolegji i Apelit verën se Shkalla e I-rë gabimisht ka vendosur për kërkesën për paga të paditësit pasi që paditësi në bazë të formularit të kërkesës që ekziston në dosje ai ka kërkuar tek Autoriteti i Likuidimit vetëm pagat e vitit 2009 në shumë prej 3,565.40 euro, si dhe pagat e vitit 2013 në shumë prej 4,600 euro. Paditësi nuk ka kërkuar paga prej NSH-së për vitin 2012 dhe as paga për vitet paraprake përveç vitit 2009. Kështu që Shkalla e I-rë ka vendosur ti aprovoj paga për vitin 2012, e që në fakt kjo nuk ishte kërkesë e paditësit.

Kolegji i Apelit nuk pajtohet me konstatimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për paga tërësisht është parashkruar. Kjo për faktin se paditësi me parashtresën e tij të dorëzuar në bazë të urdhrit të Shkalles së I-rë me datë 4 prill 2024 ka dorëzuar, formularin e kërkesës, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 02.02 2015, njoftimin për mundësinë e paraqitjes së kërkesave tek Autoriteti i Likuidimit një certifikatë të kontributit pensional të NSH GENCI, një shkresë të NSH GENCI nga e cila shihet se bordi i drejtorëve i AKP-së ka marrë vendim për emërimin e paditësit si drejtor të përkohshëm të ndërmarrjes, një vërtetim të NSH GENCI në bazë të cilit vërtetohet obligimi i NSH ndaj paditësit lidhur me pagat e kërkuara, një kontratë punë për kohë të caktuar e datës 01.05.2014, dhe kopjen e letërnjoftimit.

Kolegji i Apelit konstaton se duke u bazuar në njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës del që pagat e kërkuara nga paditësi për vitin 2013, nuk janë parashkruar me që njoftimi e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit të kërkesës. Ndërsa pagat e kërkuara për vitin 2009 janë të parashkruara për faktin se paditësi nuk ka dorëzuar asnjë provë që vërteton se ato paga i ka kërkuar brenda tri viteve në Gjykatën kompetente. Këto paga janë kërkuar me datë 24 mars 2015 tek Autoriteti i Likuidimit që është vonë pasi që tejkalon afatin tre vjeçar të parashkrimit siç kërkon neni 608 i Ligjit të Punës së bashkuar.

Kolegji i Apelit ka vendosur ta ndryshoj pikën **I** të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar dhe paditësit ti njihet e drejta në paga për vitin 2013, në shumë prej 4,600.00 euro, e jo në shumë prej 3,560.00 euro siç ka vendosur gabimisht Shkalla e I-rë e DHPGJ-së. E drejta në paga për vitin 2013 mbështetet në prova nga paditësi pasi që ai e ka dorëzuar një vërtetim të NSH "GENCI" të datës 31.12.2014, me të cilin vërtetohet se për vitin 2013, borxhi i NSH-së është 4,600.00 euro.

Kolegji i Apelit nuk e pranon si të bazuar pretendimin e paditësit se ai ka të drejtë në paga edhe për vitin 2009 në shumë prej 3,565.40 euro, pasi që siç u tha më lartë kjo pjesë e kërkesës për paga është parashkruar.

Kolegji i Apelit po ashtu nuk e pranon pretendimin e AKP-së se kërkesa e paditësit për paga është parashkruar. Kjo për faktin se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës, të cilin paditësi e ka sjellë si provë në Gjykatë, siç ka konstatuar shumë here Kolegji i Apelit në jurisprudencën e tij të deri tanishme, e ndërpre në rrjedhën e parashkrimit të kërkesës.

Prandaj nga arsyet e cekura Kolegji i Apelit pjesërisht e aprovon ankesën si të bazuar duke ndryshuar pikën **I** të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar, ndërsa ankesën e AKP-së e refuzon si të pa bazuar, kurse i vërteton pikën **II** dhe **III** të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

## **Taksat gjyqësore**

Ankuesit tashmë e kanë paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumën prej 100 euro-AKP-ja me datën 15 gusht 2024, dhe paditësi në shumë prej 30 euro me datë 01 gusht 2024 andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së 29 nëntor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues \_\_\_\_\_